



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **26.09.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar (SP për KK) Mihajlovo, selia e të cilit gjendet në Kavadar, në kuadër të objektit ku është vendosur edhe Qendra Rajonale për Punë Kufitare Jug.

Vizita buron nga mandati i Avokatit të Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, e cila është parashikuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ definohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku mund të kryhet privimi nga liria i personave, me qëllim të identifikimit të rreziqeve dhe parandalimit të torturës ose llojeve tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN hasi në bashkëpunim dhe kooperim nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Stacionin Policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë këqyrjes në zyrat zyrtare dhe hapësirat e tjera të Stacionit Policor, nga ana e ekipit, MPN vërejti një kablo elektrik në hapësirat zyrtare të Stacionit Policor, i cili do të mund të shfrytëzohej për dhunë dhe frikësim.

Në momentin e vizitës, në Stacionin Policor kishte formularë për njohjen e azilit dhe listë të avokatëve, me qëllim që në rastet kur ndonjëri nga personat do të kërkojnë të thërrasin avokatë.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP për KK Mihajlovo zbatohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për Procedurat Standarde Operative të cilat kanë të bëjnë me

kategoritë vulnerabile të të huajve, fëmijëve të pashoqëruar, si dhe për identifikimin e viktimave të qenieve njerëzore.

Stacioni policor për KK dhe MK Mihajlovo nuk është caktuar si stacion policor në të cilin do të mund të kryhej ndalimi i personave, për shkak se i njëjti nuk disponon me hapësira të veçanta për ndalim.

Në këtë Stacion Policor nuk referohen fare personat të cilët është e nevojshme të arrestohen, përkatësisht të privohen nga liria ose të ndalohen, ndërsa në situata të jashtëzakonshme, kur ndonjë person do të arrestohet për një kohë të shkurtër në stacion, bisedat i zhvillojnë në zyrën e zëvendës-eprorit apo në ndonjë zyrë të inspektorëve të cilat gjenden në katin e epërm në kuadër të objektit të njëjtë, për shkak se Stacioni Policor nuk ka hapësira të veçanta për bisedë.

Ekipi i MPN u informua se ky Stacion Policor nuk ka kapacitet dhe kushte për ndalimin e personave, as në kuadër të 24 orëve të lejuara me ligj për shkak të kryerjes së kontrolleve kufitare. Së këtejmi, siç shihej nga evidenca, asnjëri nga personat e privuar nga liria nuk është ndaluar në këtë Stacion Policor, por të njëjtit menjëherë, apo më së shumti në kohëzgjatje prej dy orësh referohen tek SP Negotinë.

Nuk janë vendosur udhëzimet për të drejtat e personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria në hapësirën e zëvendës-eprorit ku zhvillohet biseda me këta persona.

Në Stacionin Policor nuk ka tualete të veçanta për personat e arrestuar, përkatësisht personat e privuar nga liria.

Në zyrën e zyrtarëve të kalimit kufitar, krahas Kodeksit të etikës, në vend të dukshëm ishin vendosur udhëzimet për të drejtat e personave të thirrur, të arrestuar ose personave të ndaluar në tri gjuhë, por vërejtja është se këto udhëzime nuk ishin vendosur në zyrën e eprorit, por ishin vendosur në korridorin e Stacionit Policor.

Ekipi i MPN konstatoi se ky Stacion Policor, Regjistrat për evidencë mbahen në mënyrë kronologjike, dhe nuk përdoret korrektori, ndërsa është evidente lidhja numerike e Regjistratit për ngjarjet e ditës me regjistrat e tjerë.

Ekipi i MPN gjatë kësaj vizite konstatoi se nëpunësit policor duhet të vendosin praktikë të profilimit fillestar të personave të hasur-të huaj, me qëllim të identifikimit të shenjave të vulnerabilitetit, në përputhje me Procedurat Standarde Operative. Gjithashtu, të ndërpritet praktika e deportimit të migrantëve pa filluar procedura përkatëse për kthimin e personave përmes kufirit.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe drejtoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacionit Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi me personat e privuar nga liria, personat e paraburgosur dhe personat e ndaluar.